



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

DRAFT PASQYRAT FINANCIARE TË BQK-së
/për tremujorin e parë 2019/
-Raport i ndërmjetëm i paaudituar-

Departamenti për Planifikim dhe Raportim Financiar

Pasqyrat financiar të BQK-së për tremujorin e parë 2019

E përcaktuar me Ligjin 03/L-209 “Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (me iniciale BQK), si kornizë raportuese për përgatitjen e pasqyrave financiare janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përkatësisht nenit 58 të Ligjit të përmendur më lartë. Këto pasqyra për tremujorin e parë përfshijnë *pasqyrën e gjendjes financiare dhe llogarinë e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe rezerva (ekuitet)*. Viti financiar i BQK-së përputhet me vitin kalendarik, si rrjedhojë, data e raportit për pasqyrat financiare të tremujorit të parë 2019 është 31 mars 2019.

Shkurtesa të përdorura në raport:

BQK – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

DST (SDR) – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes

TI – Teknologjia Informative

SNP – Sistemi ndërbankar i pagesave

BQE (ECB) – Banka Qendrore Evropiane

USD – Dollar Amerikan

Pasqyra e gjendjes financiare

sipas të dhënave me:

	Shënim	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Mjetet			
Paraja e gatshme	5	318,285,344.10	285,376,364.49
Llogaritë rrjedhëse	6	152,314,971.67	34,797,033.53
Letrat me vlerë	7	680,593,233.50	758,889,559.97
Plasmanët në tregun e parasë	8	183,991,771.85	183,734,361.96
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	326,628,487.80	326,051,143.81
Prona dhe pajisjet	10	4,872,076.35	5,015,903.52
Mjetet e paprekshme	11	1,679,440.15	1,790,110.48
Mjete tjera	12	1,698,953.86	1,410,439.92
Gjithsej mjetet		1,670,064,279.28	1,597,064,917.68
Detyrimet			
Ndaj bankave komerciale në vend	13	381,920,304.72	343,393,712.93
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	323,225,103.59	321,854,091.99
Ndaj institucioneve qeveritare	15	790,622,104.22	762,900,887.21
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	115,775,425.31	110,862,984.73
Nga huamarrja/et	17	2,266,259.07	2,266,259.07
Detyrime tjera vendore	18	1,541,878.17	1,797,522.58
Gjithsej detyrimet		1,615,351,075.08	1,543,075,458.51
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i autorizuar	19	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondi rezervë	20	23,989,459.17	21,801,120.78
Neto rezultati i periudhës		723,745.03	2,188,338.39
Gjithsej kapitali dhe rezervat		54,713,204.20	53,989,459.17
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		1,670,064,279.28	1,597,064,917.68

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shpalosura më poshtë janë aprovuar nga menaxhmenti më datë 30 maj 2019 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:


 Fehmi Mehmeti
 Guvernator


 Faton Ahmetaj
 Drejtor për Planifikim dhe
 Raportim Financiar

Pasqyra e përmbledhur e të ardhurave

	Shënim	31 mars 2019	31 mars 2018
Të hyrat nga interesi (kamata)			
Të hyrat nga interesi		837,379.89	598,237.65
Shpenzimet nga interesi		(306,821.66)	(388,940.64)
Neto të hyrat nga interesi	21	530,558.23	209,297.01
Të hyrat nga tarifatat dhe ndalesat			
Të hyrat nga tarifatat dhe ndalesat		586,979.41	471,745.67
Shpenzimet nga tarifatat dhe ndalesat		(101,352.06)	(30,147.25)
Neto të hyrat nga tarifatat dhe ndalesat	22	485,627.35	441,598.42
Të hyrat nga aktiviteti rregullator dhe të hyra tjera operative			
Të hyrat nga aktiviteti rregullator	23	1,002,100.00	980,300.00
Të hyrat nga grantet	24	24,640.47	24,306.12
Të hyrat tjera operative	25	121.44	284.63
Të ardhurat operative (21+22+23+24+25)		2,043,047.49	1,655,786.18
Shpenzimet administrative			
Shpenzimet për personelin	26	(1,043,665.12)	(992,858.70)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(259,477.50)	(249,970.19)
Shpenzime të përgjithshme administrative	27	(253,276.25)	(243,353.81)
Shpenzimet administrative¹		(1,556,418.87)	(1,486,182.70)
Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit		486,628.62	169,603.48
Neto fitimi/humbja nga kursi i këmbimit valutor	28	237,116.41	(271,089.34)
Neto rezultati i periudhës		723,745.03	(101,485.86)

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

¹ Gjithsej shpenzimet operative = shpenzimet administrative + shpenzimet nga tarifatat dhe ndalesat.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (kapital dhe rezerva)

	Kapitali i autorizuar	Fond i rezervave	Neto rezultati i periudhës	Gjithsej
<i>Saldo me 01 Janar 2018</i>	30,000,000.00	22,682,588.69	(881,467.91)	51,801,120.78
<i>Rezultati financiar i periudhës</i>	-	-	2,188,338.39	2,188,338.39
<i>Transferi në fondin rezervë</i>	-	(881,467.91)	881,467.91	-
<i>Transferi në kapital të autorizuar</i>	-	-	-	-
<i>Saldo më 31 dhjetor 2018</i>	30,000,000.00	21,801,120.78	2,188,338.39	53,989,459.17
<i>Saldo më 01 janar 2019</i>	30,000,000.00	21,801,120.78	2,188,338.39	53,989,459.17
<i>Rezultati financiar i periudhës</i>	-	-	723,745.03	723,745.03
<i>Transferi në fondin rezervë</i>	-	2,188,338.39	(2,188,338.39)	-
<i>Transferi në kapital të autorizuar</i>	-	-	-	-
<i>Saldo më 31 mars 2019</i>	30,000,000.00	23,989,459.17	723,745.03	54,713,204.20

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

1. Institucioni Raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, e cila operon sipas Ligjit nr. 03/L-209“Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” të aprovuar në korrik të vitit 2010.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Korniza Raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të kostos historike dhe të harmonizuara sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Valuta e funksionale dhe e prezantuar

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në EURO, që është valutë zyrtare funksionale e Kosovës. Në rast se vlerat janë të shprehura në valuta tjera atëherë do të këtë shënim përkatës aty ku janë të paraqitura ato.

3. Politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë të përgatitura duke shfrytëzuar konsistencën e politikave kontabël, dhe duhet theksuar se nuk ka pasur ndonjë politikë të re ose ndryshim në politikat e aplikuara kontabël.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Rreziku financiar në BQK është i paraqitur në formën e: rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut kreditor dhe rrezikut të tregut. Rreziku financiar në BQK ndërlidhet kryesisht me punët e menaxhimit të mjeteve dhe menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve në përputhje me politikën e menaxhimit të mjeteve të aprovuar nga Bordi i BQK-së. Mjetet e ekspozuara nga aktiviteti i menaxhimit financiar të tyre janë kryesisht në shtete të Bashkimit Evropian me vlerësim kreditor të investueshëm (prej AAA deri BBB+/Aaa deri Baa3).

Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit (vazhdim)**Vlerat bartëse sipas maturitetit të mbetur**

	Shënim	Shuma e bartur	më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6 muaj - 1 vit	1 - 5 vite	mbi 5 vite
31 mars 2019							
Mjetet							
Paratë e gatshme	5	318,285,344.10	318,285,344.10	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse	6	152,314,971.67	152,314,971.67	-	-	-	-
Letra me vlerë	7	680,593,233.50	995,970.70	-	130,890,563.22	548,706,699.58	-
Plasmanët në tregun e parasë	8	183,991,771.85	8,991,771.85	175,000,000.00	-	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	326,628,487.80	176,682,608.80	8,680,427.00	17,360,854.00	123,904,598.00	-
		1,661,813,808.92	657,270,667.12	183,680,427.00	148,251,417.22	672,611,297.58	-
Detyrimet							
Ndaj bankave vendore	13	(381,920,304.72)	(381,920,304.72)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(323,225,103.59)	(173,279,224.59)	(8,680,427.00)	(17,360,854.00)	(123,904,598.00)	-
Ndaj institucioneve qeveritare	15	(790,622,104.22)	(790,622,104.22)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	(115,775,425.31)	(115,775,425.31)	-	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(2,266,259.07)	-	-	-	(679,877.72)	(1,586,381.35)
Detyrime tjera vendore	18	(1,541,878.17)	(1,541,878.17)	-	-	-	-
		(1,615,351,075.08)	(1,463,138,937.01)	(8,680,427.00)	(17,360,854.00)	(124,584,475.72)	(1,586,381.35)
		46,462,733.84	(805,868,269.89)	175,000,000.00	130,890,563.22	548,026,821.86	(1,586,381.35)
31 dhjetor 2018							
Mjetet							
Paratë e gatshme	5	285,376,364.49	285,376,364.49	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse	6	34,797,033.53	34,797,033.53	-	-	-	-
Letra me vlerë	7	758,889,559.97	(0.00)	-	227,220,601.98	531,668,957.99	-
Plasmanët në tregun e parasë	8	183,734,361.96	8,734,361.96	-	175,000,000.00	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	326,051,143.81	170,173,004.81	8,530,040.00	17,060,081.00	130,288,018.00	-
		1,588,848,463.76	499,080,764.79	8,530,040.00	419,280,682.98	661,956,975.99	-
Detyrimet							
Ndaj bankave vendore	13	(343,393,712.93)	(343,393,712.93)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(321,854,091.99)	(165,975,952.99)	(8,530,040.00)	(17,060,081.00)	(130,288,018.00)	-
Ndaj institucioneve qeveritare	15	(762,900,887.21)	(762,900,887.21)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	(110,862,984.73)	(110,862,984.73)	-	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(2,266,259.07)	-	-	-	(679,877.72)	(1,586,381.35)
Detyrime tjera vendore	18	(1,797,522.58)	(1,797,522.58)	-	-	-	-
		(1,543,075,458.51)	(1,384,931,060.44)	(8,530,040.00)	(17,060,081.00)	(130,967,895.72)	(1,586,381.35)
		45,773,005.25	(885,850,295.65)	-	402,220,601.98	530,989,080.27	(1,586,381.35)

5. Paraja e gatshme

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Paraja e gatshme	318,285,344.10	285,376,364.49
Gjithsej	318,285,344.10	285,376,364.49

Vërehet një rritje e saldos m 31 mars 2019 krahasuar më 31 dhjetor 2018. Kjo rrjedh nga mundësitë e vogla të plasimit (afatizimit) të mjeteve në tregjet financiare si rrjedhojë e normave shumë të ulëta dhe negative (për valutën euro). Kështu është vendosur që të mbahen më shumë mjete si para të gatshme për t'ju ikur normave negative, që bankat korrespondente na ngarkojnë mbi limite të caktuara në llogaritë rrjedhëse (nostro).

6. Llogaritë rrjedhëse (nostro - me bankat jorezidente)

Përbërja e llogarive rrjedhëse me banka jovendore është si më poshtë:

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Deutsche Bundesbank	41,170,000.00	500,000.00
Raiffeisen Zentralbank	9,927,651.39	9,919,971.54
Banque centrale du Luxembourg	343.36	343.36
Deutsche Bank	99,586,016.76	24,133,499.52
Nostro Acc. Commerzbank AG	449,692.00	9,844.00
Nostro Acc. Bayerische Landesbank	989,992.72	9,998.02
Nostro acc. with FED	191,275.44	223,377.09
Gjithsej	152,314,971.67	34,797,033.53

Pozicioni i *llogarive rrjedhëse* (nostro) krahasuar më 31 dhjetor 2018 është rritur dukshëm, ndryshimi është rrjedhë e aktivitetit të këtyre llogarive dhe e menaxhimit të portofolios së mjeteve e efektuar edhe nga normat negative në tregjet financiare (përkatësisht shënimeve 5, 6, 7 dhe 8, që janë shumë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën referuar nga aspekti i menaxhimit të mjeteve). Rritja në këtë grup mund të ketë efekt në rritjen e shpenzimeve të interesit nga normat negative që bankat korrespondente (përfshirë këtu llogarinë me FED – Federal Reserve) aplikojnë në llogaritë e shpalosura më lartë.

7. Letrat me Vlerë (Bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupit nën shënimin 7 janë letra të borxhit të lëshuara (emetuara) nga vende dhe institucione të ndryshme të Evropës, në analitikë shpërndarja gjeografike është sipas listimit në faqe 9 (në tabelën *sipas shpërndarjes gjeografike*). Bonot e Thesarit të shpalosura po ashtu në faqe 9, kanë maturitet deri në një vit. Ndërsa ato të obligacioneve qeveritare kanë maturitet deri në pesë vite. Të gjitha janë në Euro dhe kanë norma të interesit efektiv që lëvizin nga 0.019% deri 3.021% vjetore në vitin 2019 (në vitin 2018 periudha e njëjtë raportuese: 0.008% deri në 1.716% vjetore).

Letrat me vlerë sipas shpërndarjes gjeografike dhe llojit:**Letra me vlerë (sipas shpërndarjes gjeografike):**

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Gjermani	67,140,011.91	67,125,782.03
Francë	10,031,236.05	10,029,732.20
Holandë	12,776,767.37	12,772,324.34
Itali	105,345,565.70	176,834,343.28
Slloveni	21,708,894.08	22,137,623.18
Luksemburg	90,273,167.48	90,243,505.98
EuroFima-Switzerland (Zvicër)	6,040,741.13	6,039,989.48
KommuneKredit-Danimarkë	6,065,221.51	-
Austria	79,467,273.80	79,463,267.63
Irlandë	104,248,570.41	105,389,752.07
Kosovë	177,495,784.06	188,853,239.79
Gjithsej	680,593,233.50	758,889,559.97

Letra me vlerë (sipas llojit):

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Bonot e thesarit	995,970.70	5,998,422.16
Obligacione	679,597,262.81	752,891,137.81
Gjithsej	680,593,233.50	758,889,559.97

Në kuadër të grupit vërehet një zvogëlim i pozicionit krahasuar me periudhën 31 dhjetor 2018 që është rrjedhë normale e menaxhimit të portfolios, kryesisht e bazuar në sigurinë e mjeteve së pari pastaj edhe në mundësitë për norma më optimale të kthimit të mjeteve.

8. Plasmanët në tregun e parasë (me bankat jorezidente)

Në kuadër të këtij grupimi bëjnë pjesë plasmanët në tregun e parasë në bankat tona korrespondente. Norma e kamatës për këto plasmane deri në tremujorin e parë 2019 mesatarisht është rreth 0.389% (minimum: 0% dhe maksimum: 3.10%), ndërsa në vitin 2018: në mesatare prej 0.659% (minimum: 0% dhe maksimum: 3.040%). Këto plasmane kryesisht kanë maturitet të kontraktuar deri në një vit. Analitika sipas bankave është e shpalosur në tabelën si më poshtë:

Plasmanët në tregun e parasë sipas bankave:	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Deutsche Bank	175,000,000.00	175,000,000.00
FED New York	8,991,771.85	8,734,361.96
Gjithsej	183,991,771.85	183,734,361.96

Ashtu sikurse edhe vërehet lehtë nëse i krahasojmë nuk ka ndryshim për t'u theksuar në mes 31 dhjetorit 2018 dhe 31 marsit 2019. Plasmanët aktive në euro në datën e raportimit janë 175 milion. Ndërsa, kemi një plasmanë prej 10.1 milionë në USD të afatizuar në datën e raportimit (në tabelë është e shprehur kundërvlera në euro).

9. Mjetet e ndërlidhura me FMN

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Kuota me FMN	102,064,520.59	100,296,274.71
Depozitat në DST (SDR)	65,228,633.18	64,890,248.43
Kamata akruale	709,028.42	721,461.70
Përdorimi i fondeve të FMN-së (SBA)	158,626,305.61	160,143,158.97
Gjithsej	326,628,487.80	326,051,143.81

Zërat më lartë rrjedhin nga anëtarësimi i Kosovës në FMN. Kuota me FMN paraqet vlerën e kuotës së obligueshme (82,600,000 SDR nga muaji shkurt 2016; ndërsa fillimisht ka qenë 59,000,000 SDR) që i është përcaktuar Kosovës nga FMN-ja e shprehur në euro.

Ndërsa depozitat në DST (SDR) paraqet fillimisht vlerën e depozituar në DST në emër të Republikës së Kosovës sipas vendimeve të Bordit të Guvernatorëve të FMN-së më 28 gusht 2009 (43,737,278 SDR) dhe 9 shtator 2009 (11,631,135 SDR) e ndryshuar për transaksionet – të hyrat dhe shpenzimet e interesit dhe pagesat në emër të rritjes së kuotës po ashtu të shprehura në euro në tabelën më lartë.

Depozitat në DST – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes (Special Drawing Rights – SDR) janë depozita që sjellin interes mesatarisht prej 1.129% për periudhën raportuese janar - mars 2019 (ndërsa për janar – mars 2018, 0.789%).

Zëri përdorimi i fondeve të FMN-së paraqet mjetet e marra nga FMN-ja sipas marrëveshjeve aktive për shfrytëzim të linjës kreditore (SBA) nga Qeveria e Kosovës. Ndryshimi rrjedhë nga disbursimet e reja, pagesat për linjat kreditore (SBA) aktive si dhe nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR (vlerësimi i SDR-ve kundrejt EURO-s).

10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme

Kategoria e Mjeteve Themelore	Kosto Historike	Zhvlerësimi/ Amortizimi i Akumuluar deri më 31 dhjetor 2018	Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar i vitit deri me 31 mars 2019	Gjithsej Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar 31 mars 2019	Vlera Neto më 31 mars 2019
<i>Prona, ndërtesat dhe pajisjet</i>	10,122,818.90	5,101,935.38	162,166.74	5,264,102.12	4,858,716.78
Pajisje, zyra dhe tjera	2,435,166.98	1,907,382.85	45,188.73	1,952,571.58	482,595.40
Automjetet	320,149.16	290,593.50	7,239.93	297,833.43	22,315.73
Ndërtesa	5,201,291.64	1,153,434.48	65,016.12	1,218,450.60	3,982,841.04
Pajisjet kompjuterike	2,166,211.12	1,750,524.55	44,721.96	1,795,246.51	370,964.61
<i>Mjetet e Paprekshme</i>	3,971,065.08	2,180,954.60	97,310.76	2,278,265.36	1,692,799.72
Aplikacionet kompjuterike	3,971,065.08	2,180,954.60	97,310.76	2,278,265.36	1,692,799.72
Aplikacione në proces	-	-	-	-	-
<i>Gjithsej</i>	14,093,883.98	7,282,889.98	259,477.50	7,542,367.48	6,551,516.50

12. Mjetet tjera

Mjetet tjera përbëhen si më poshtë:

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Të hyra akruale	1,106,092.02	1,278,473.28
Parapagime	375,111.84	131,966.64
Pagesa/Kërkesa në proces (SNP/DepoX)	217,750.00	-
Gjithsej	1,698,953.86	1,410,439.92

13. Detyrimet ndaj bankave në vend

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
ProCredit Bank - Kosovë	57,477,827.64	40,597,389.47
Raiffeisen Bank - Kosovë	62,005,459.98	45,299,798.01
NLB Prishtina	55,376,366.68	69,917,264.03
Komercijalna Banka - Dega Mitrovicë	6,750,223.01	6,358,190.34
Banka Ekonomike e Prishtinës	63,592,804.01	55,869,253.21
Banka për Biznes	45,515,995.09	39,220,850.40
Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë	32,832,236.87	32,538,906.01
Turk Ekonomi Bankasi Sh.A	41,473,693.31	37,462,030.03
Turkiye Is Bankasi A.S.	10,174,333.62	14,421,855.38
T.C. Zirat Bankasi A.S.Dega Kosovë	6,705,502.25	1,678,865.90
Banka Kreditore e Prishtinës	15,862.26	29,310.15
Gjithsej	381,920,304.72	343,393,712.93

Të shpalosura në këtë grup janë saldot e bankave komerciale që operojnë në vend (Kosovë). Ato në BQK mbajnë mjetet sipas rregullativës ligjore për rezervën e likuiditetit. Në total shuma e shpalosur më lartë për periudhën raportuese 31 mars 2019 është rreth 2.58 herë më e lartë se sa shuma e rezervës së obliguar që duhet mbajtur në BQK.

14. Detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Llogaria rrjedhëse FMN Nr. 1	255,161.30	250,740.69
Llogaria shpenzimeve FMN Nr. 2	6,178.24	6,071.20
Llogaria e FMN-së, në përkujdesje	235,642,388.66	235,824,955.07
Pjesa e paguar e Kuotës të FMN-ja	18,190,629.59	17,816,089.91
Alokime nga FMN-ja në formë të DST	68,415,865.97	67,230,575.79
Kamata akruale	714,879.83	725,659.33
Gjithsej	323,225,103.59	321,854,091.99

Zërat më lartë paraqesin pozicionet e llogarive të ndërlidhura me FMN-në që kanë rrjedhur pas anëtarësimit të Kosovës në FMN.

Të tre zërat e parë (tabela nën shënim 14) paraqesin llogari të hapura sipas rregullativës së FMN-së, dy janë llogari operative dhe një është llogari në përkujdesje për letrat me vlerë që Qeveria e Kosovës i ka lëshuar si nota të pagueshme ndaj FMN-së.

Pjesa e paguar e kuotës, ka të përfshirë edhe interesin e paguar nga IMF për këtë zë, sipas rregullativës së FMN-së, e cila në tabelë nën shënim 14 është e shprehur në euro.

Alokimet në formë të Drejtave Speciale të Tërheqjes (DST/SDR) në FMN, përbëhen nga alokimet e përmendura në *shënimin 9* më 28 gusht dhe 9 shtator 2009, të cilat së bashku gjithsej arrijnë vlerën prej 55,368,413 DST (SDR) po ashtu të shprehura në euro në tabelën e shënimit 14. Norma e interesit për zërin e alokimeve për periudhën raportuese është e njëjtë sikurse te depozitat DST (SDR).

15. Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare kanë këtë përbërje:

Llogarit rrjedhëse	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Thesari – Ministria e Financave	440,868,309.79	374,662,826.78
Agjencia Kosovare për Privatizim	349,657,816.57	388,115,936.82
Institucionet e përkohshme administrative	95,977.86	122,123.61
Gjithsej (llogari rrjedhëse)	790,622,104.22	762,900,887.21

Depozitat në llogari rrjedhëse përfitojnë kamatë prej 0.00% (si për periudhën raportuese, ashtu edhe për periudhën krahasuese). Afatizime aktive në periudhën raportuese nuk ka, po ashtu edhe për vitin 2018, përkatësisht më 31 dhjetor 2018 nuk ka pasur afatizime aktive. Ndryshimi është rrjedhë e aktivitetit operativ të institucioneve që përbëjnë grupin.

16. Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale

Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale të paraqitura në vijim të gjitha janë mjete në llogari rrjedhëse:

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Kompanitë e sigurimeve	4,485,643.64	4,536,787.25
Institucione dhe kompani publike	111,288,037.84	106,324,447.65
Fondet e pensioneve dhe tjera	1,743.83	1,749.83
Gjithsej	115,775,425.31	110,862,984.73

Ka një rritje krahasuar me 2018, që i atribuohet tërësisht grupit të institucioneve publike. Edhe këtu duhet të theksojmë se ndryshimi rrjedh nga aktiviteti operativ i institucioneve/llogarive që përbejnë grupin.

17. Detyrimet nga Huamarrja/et

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Huamarrje nga Banka Botërore	2,266,259.07	2,266,259.07
Gjithsej	2,266,259.07	2,266,259.07

Kemi dy projekte që janë financuar nga Banka Botërore përmes kredisë: projekti për *Planin e vazhdimësisë së punës* dhe projekti për *Sistemin e pagesave në kohë reale* (RTGS). Projekte këto të implementuara në vitin 2016. Kthimi i mjeteve është me afat mbi 10 vjet.

18. Detyrime tjera

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Llogari në përkujdesje	756,036.51	756,036.51
Të hyrat e shtyra	473,166.91	497,810.68
Llogari të pagueshme dhe shpenzime akruale	312,674.75	543,675.39
Gjithsej	1,541,878.17	1,797,522.58

Në kuadër të grupit vërehet zvogëlim i lehtë në gjithsej saldon e grupit krahasuar më 31 dhjetor 2018. Kryesisht i ndikuar nga zvogëlimi i saldosh të *llogarive të pagueshme* dhe të *hyrave të shtyra* më 31 mars 2019, krahas asaj më 31 dhjetor 2018.

19, 20 Kapitali i autorizuar dhe Rezervat**Kapitali dhe Rezervat e Përgjithshme**

	31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Kapitali i autorizuar	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondet Rezervë	23,989,459.17	21,801,120.78
Rezultati neto i periudhës	723,745.03	2,188,338.39
Gjithsej	54,713,204.20	53,989,459.17

Rezultati financiar është pozitiv për rreth 724 mijë euro, i ndikuar kryesisht nga realizimi i kënaqshëm për të hyrat dhe mbajtja e shpenzimeve sipas planifikimit buxhetor për periudhën raportuese. Zëri i rivlerësimit valutor në datën e raportimit është në vlerë prej rreth 237 mijë euro (si fitim i përcaktuar), dhe nëse e përjashtojmë këtë rezultati financiar mbetet pozitiv prej rreth 487 mijë euro.

21. Neto të hyrat nga kamatat

	31 mars 2019	31 mars 2018
Të hyrat nga kamata		
Prej afatizimeve në plasmane	52,943.32	28,093.90
Prej letrave me vlerë	451,790.50	314,227.04
Prej depozitave me llogaritë me FMN (DST/SDR ne posedim)	182,427.17	129,441.70
Prej normave negative në depozita ²	150,218.90	126,475.01
	837,379.89	598,237.65
Shpenzimet e kamatave		
Ndaj llogarive me FMN (DST/SDR të alokuar)	190,417.49	129,167.66
Ndaj bankave korrespondente	113,129.38	258,502.50
Nga huazimi/et	3,274.79	1,270.48
	306,821.66	388,940.64
Neto të hyrat nga interesi	530,558.23	209,297.01

Siç mund të vërehet nga tabela nën shënimin 21, të hyrat nga kamatat janë realizuar më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa, shpenzimet nga kamata janë më të ulëta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Kjo ka ndikuar që neto të hyrat nga kamata janë po ashtu me të larta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Normat mesatare të kamatës për neto të hyrat nga kamatat (duke marrë në konsiderate vetëm portfolion e angazhuar) për periudhën raportuese janë rreth 0.245% (në periudhën e njëjtë të vitit 2018 0.107%).

22. Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat në shërbime

	31 mars 2019	31 mars 2018
Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat		
Nga depozitat/tërheqjet në para të gatshme	183,248.52	133,760.03
Nga transferet hyrëse	23,005.00	16,635.00
Nga transferet dalëse	87,640.00	68,829.92
Nga transferet vendore (<i>Sistemi i pagesave vendore</i>)	235,152.99	205,349.92
Nga sistemi i regjistrimit të kreditove	48,252.90	37,875.80
Të hyra nga tarifa tjera	9,680.00	9,295.00
	586,979.41	471,745.67
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		
Prej transportit të parasë së gatshme	98,760.56	28,224.84
Nga transaksionet me banka korrespondente	2,591.50	1,922.41
Prej shërbimeve të pagesave përmes SNP	-	-
	101,352.06	30,147.25
Neto pozicioni nga tarifat dhe ndalesat	485,627.35	441,598.42

Vërehet një rritje e lehtë krahasuar me 31 mars 2018, kjo është rrjedhë normale (ndryshim në volum) e aktivitetit për zërat e shpalosur në kuadër të grupit dhe pjesërisht nga rregullimet në listën e tarifave për llojin e shërbimeve të shpalosura më lartë.

²Duke ju referuar normave negative që po përcjellin tregjet financiare të valutës euro, bazuar edhe në normat referente të BQE (ECB), BQK ka vendosur norma negative në disa nga depozituesit e saj që nga shtatori 2016.

23. Të hyrat nga aktiviteti rregullator

	31 mars 2019	31 mars 2018
Nga mirëmbajtja e licencave të bankave	629,000.00	620,000.00
Nga licencat prej institucioneve bankare	14,200.00	4,300.00
Nga mirëmbajtja e licencave të kompanive të sigurimeve	270,000.00	256,000.00
Nga licencat prej kompanive të sigurimeve	18,700.00	30,700.00
Të hyrat nga aktiviteti rregullator i fondeve pensionale	6,000.00	6,000.00
Nga aktiviteti rregullator i institucioneve tjera financiare (jobankare)	64,200.00	63,300.00
Gjithsej	1,002,100.00	980,300.00

Ndryshimi si rritje kryesisht është e mbështetur në rritjen e bazës (volumit të aktivitetit) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018 (si rrjedhë e trendit historik që ka ky grup i zërave).

24. Të hyrat nga grantet

	31 mars 2019	31 mars 2018
Të hyrat nga grantet	24,640.47	24,306.12

Dy janë grantet që për nga pesha e dominojnë zërin nën shënimin numër 24. Ato janë: granti për sistemin e menaxhimit të gjithë procesit të *emetimeve të letrave me vlerë të Qeverisë* (ku i gjithë sistemi është dhënë si grant BQK-së nga Thesari - Ministria e Financave dhe granti për *sistemin e mbikëqyrjes financiare*.

Ndërsa granti për studimin e fizibilitetit për qendër të trajnimeve ka peshë shumë më të vogël.

25. Të hyrat tjera operative

	31 mars 2019	31 mars 2018
Të hyra tjera	121.44	284.63

Ky grup përbehet nga të hyra prej aktiviteteve jo të zakonshme të BQK-së dhe të cilat nuk kanë mundur të klasifikohen në zërat specifikë të të hyrave. P.sh. shitja e tokenëve që përmbajnë certifikata për qasje në sistem Depo-x, për klientët shfrytëzues të sistemit në fjalë, kryesisht ndaj bankave komerciale dhe të ngjashme.

26. Shpenzimet e personelit

	31 mars 2019	31 mars 2018
Shpenzimet e pagave dhe kompensimeve	788,583.59	758,928.45
Shpenzimet e kontributeve dhe sigurimi shëndetësor	168,667.51	163,205.70
Shpenzimet e trajnimeve	18,435.20	11,115.46
Shpenzimet për Bordin e BQK-së	28,974.49	22,959.27
Shujta ditore	34,317.00	31,299.00
Shpenzime tjera	4,687.33	5,350.82
Gjithsej	1,043,665.12	992,858.70

Në kategorinë *tjera të shpenzimet e personelit* përfshihet *kompensimi shtesë pensional* (2019, 2,701.11euro; 2018, 2,977,58euro) dhe *mbështetja financiare për strehim* (2019, 1,987.22euro; 2018, 2,373.24euro). Kompensimi shtesë pensional është rrjedhojë e vendimeve të mëhershme, nga ku disa ish punëtorë kompensohen drejtpërdrejt nga BQK-ja, në pamundësi për bartjen e këtij detyrimit ndaj tyre të fondet pensionale në momentin kur BQK-ja ka bartur menaxhimin e fondit shtesë pensional.

27. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

	31 mars 2019	31 mars 2018
Shpenzimet e sigurimit	78,120.47	80,325.65
Riparime dhe mirëmbajtje	13,220.82	10,610.87
Mirëmbajtje të aplikacioneve	75,161.83	70,331.42
Shpenzime komunikimi (telefoni, fax-i dhe interneti)	2,551.72	2,820.64
Shpenzimet e shërbimeve publike/komunale	9,753.86	16,811.76
Shpenzimet e konsultimeve dhe të auditimit	1,742.54	1,769.23
Shpenzime të sigurimit fizik (të objektit)	-	15,528.00
Udhëtimet dhe transporti	34,872.49	16,929.38
Shpenzimet operative të automjeteve	3,035.35	2,628.24
Material shpenzues administrativ	8,342.23	3,044.76
Shpenzimet e bufesë (për kafe ndaj personelit dhe takime të ndryshme)	6,750.86	4,317.59
Shpenzime për furnizime (për pajisje të TI dhe jo TI)	2,352.00	4,617.59
Publikimet dhe literatura	2,180.00	1,112.70
Shpenzimet e përfaqësimit	3,628.46	1,958.65
Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale ³	8,752.24	8,161.13
Tjera ⁴	2,811.38	2,386.20
Gjithsej	253,276.25	243,353.81

Ndryshimi është rrjedhë e aktiviteteve dhe vendimeve operative si dhe ndonjë aktivitet që nuk ka pasur periodicitet të njëjtë në periudhat krahasuese. Por që shikuar si tërësi janë brenda trendit të tyre të zakonshëm.

³ Në kuadër të kategorisë “Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale” kryesisht janë këto: *Anëtarësimi në Shoqatën ndërkombëtare të sigurimeve (IAIS)*, *Shoqatën ndërkombëtare të pensioneve (IOPS)*, *Shoqatën ndërkombëtare të regjistrimit të kreditëve (ACCIS)*, *Institutin për auditim të brendshëm (IIA)* dhe *Bordin për standarde të raportimeve financiare (IASB-IFRS)*.

⁴ Në kuadër të kategorisë “Tjera të shpenzimet e përgjithshme dhe administrative” për periudhat raportuese janë të përfshira: *gardërobë pune* rreth 640 euro (2019) dhe 600 euro (2018); *shtypi ditor* 709 euro (2019) dhe 334.8 euro (2018); *shpenzime operative për kartelat bankare* 0.80euro (2019) dhe 0.00euro (2018); dhe *shpenzimet për parking dhe për aktivitete sportive* (kryesisht terminet për shfrytëzimin e fushave për futboll dhe volejball) 1,460.78 euro (2019) dhe 1,451.40euro (2018).

28. Neto rezultati nga ndryshimet e kursit të këmbimit

	31 mars 2019	31 mars 2018
Rivlerësimi valutor		
nga zëri/at ne USD	172,388.92	(223,665.70)
nga zërat ne SDR	64,727.49	(47,423.64)
Neto fitimi/(humbja) e perealizuar (nga ndryshimi i kursit të këmbimit)	237,116.41	(271,089.34)

Rezultati i paraqitur më lartë është i përkohshëm (specifikisht vetëm për datën e raportimit) dhe mund të lëvizë varësisht nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR dhe EUR/USD.

29. Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Shënim		31 mars 2019	31 dhjetor 2018
Paraja e gatshme	5	318,285,344.10	285,376,364.49
Llogaritë rrjedhëse me bankat jorezidente	6	152,314,971.67	34,797,033.53
Letra më vlerë me maturitet deri në tre muaj		995,970.70	-
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente dhe me maturitet deri në tre muaj		8,991,771.85	8,734,619.64
Gjithsej		480,588,058.32	328,908,017.66

30. Detyrimet e pritura dhe kontingjente**Anëtarësimi në Bankën Botërore**

Pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe nënagjencionet e saj Qeveria e Kosovës ka lëshuar nota të pagueshme (sipas kërkesës) duke u zotuar se do të paguajë sipas kërkesës së Bankës Botërore (nënagjencioneve të saj) për pjesën e tarifës së anëtarësisë. Vlera e tyre më 31 mars 2019 është rreth 645,152 euro (më 31 dhjetor 2018 ky detyrim i pritshëm ka qenë 645,152 euro), BQK luan rolin e ndërmjetësit financiar (bankës garantuese) dhe mjetet mbahen në llogari nën përkujdesje (garantuese).